



## Raporti i vitit 2016

Shkurt, 01.-29.02.2016

### 1. Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale gjatë muajit shkurt 2016, ka kryer këto aktivitete: Kerkesat per hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, shqyrtimin e kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimin e tyre në planet e Komunës, njoftimin me kohë të kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, si dhe kompletimin e dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrjen e realizimit të projekteve sipas marrëveshjes etj.

#### 1.1. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë muajit shkurt 2016, drejtoria ka proceduar 79 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike - leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 79 kërkesave të pranuar, 79 janë zgjidhur.

#### 1.2. Dërgimi i kërkesave për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave

Duke marrë për bazë Ligjin për planifikimin hapësinorë, Ligjin për ndërtimin e objekteve investive, si dhe Ligjin për projektim, e në veçanti planet rregulluese, janë dërguar kërkesat për hartimin e detyrave projektuese për këto rrugë në zonat urbane dhe rurale.

- Në muajin shkurt nuk është dërguar ndonjë detyrë projektuese.

**Shënim: Është shpallur njoftimi – tenderi për zgjedhjen e operatorit ekonomik për projektimin e rrugëve me gjithë infrastrukturë. (Hartimi i projekteve të infrastrukturës rrugore në Prishtinë 2.2.2016.)**

### **1.3. Projektet infrastrukturore të dërguara për ofertim**

Nr	Emri i projektit	Vlera e ofertuar
1.	Ndërtimi i kanalizimit fekal ( ujërave të zeza) / në vendbanim - Bardhosh dhe disa lagje në Barilevë dhe Prugoc, lagja 5.	

### **1.4. Pjesëmarrja në hapje të tenderëve në projektet Infrastrukturore**

- Në muajin shkurt nuk ka pasur hapje të tenderit

### **1.5. Pjesëmarrja në vlerësim të tenderëve në projektet infrastrukturore**

- Në muajin shkurt nuk ka pasur vlerësim të tenderit.

### **1.6. Kontratat në projektet infrastrukturore**

- Në muajin shkurt nuk është lidhur ndonjë kontratë me ndonjë operator ekonomik për ndërtimin e infrastrukturës.

### **1.7. Raportimi i menaxherëve të projekteve infrastrukturore**

- Për momentin nuk janë duke u ekzekutuar punimet në asnjë kontratë, për shkakë të motit të ligë - kushteve atmosferike në sezonin dimëror.

**Drejtori**

**Hysen DURMISHI, ing. i dipl. i ndërt.**

